

Nga një këndvështrim gjinor: Kush vendos çfarë në ekonomitë familjare në zonat rurale në Kosovë?

Ky studim është shkruar si pjesë e partneritetit me Institutin Riinvest në projektin “Zhvillimi Ekonomik Rural i Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës” (SIREN), i zbatuar nga Caritas-i Zvicëran dhe i mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), njësi operative e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim. Përmbajtja është përgjegjësi vetëm e Institutit Riinvest dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e ADA, ose të Caritas-it Zvicëran.

Përmbajtja

LISTA E FIGURAVE	2
ABSTRAKT	3
HYRJE.....	4
METODOLOGJIA	5
Hulumtimi sasior (anketa).....	5
Hulumtimi cilësor	6
GJETJET.....	8
Të dhënat demografike.....	8
Vendimmarrja në familje	11
Gjetjet nga diskutimi në fokus grup	25
SHËNIMET PËRMBYLLËSE DHE REKOMANDIME	26

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Struktura gjinore e të anketuarve.....	8
Figura 2. Struktura e moshës së të anketuarve	9
Figura 3. Struktura e nivelit arsimor të të anketuarve sipas gjinisë.....	9
Figura 4. Statusi i punësimit sipas strukturës gjinore	10
Figura 5. Struktura e të ardhurave neto sipas gjinisë	10
Figura 6. Menaxhimi i të ardhurave familjare	11
Figura 7. Vendimmarrja, punësimi dhe arsimimi.....	12
Figura 8. Menaxhimi i shpenzimeve mujore të ekonomisë familjare.....	13
Figura 9. Personi që vendos për blerjet ditore të familjes.....	13
Figura 10. Personi që vendos për blerjet më të shtrenjta të familjes	14
Figura 11. Personi që vendos për investime/blerje të gjërave kryesore të familjes	14
Figura 12. Personi që vendos për shitjen e aseteve të familjes.....	15
Figura 13. Personi që vendos të marrë ose jo një kredi	16
Figura 14. Personi që vendos se sa para duhet të kursehen	16
Figura 15. Kush ka të ardhura më të larta?.....	17
Figura 16. Personi që duhet të marrë vendimet e rëndësishme në familje	18
Figura 17. Pronari ligjor i pronës në të cilën banon familja	19
Figura 18. Personi përgjegjës për: planifikimin për shkollim, planifikimin familjar, vendbanimin, festat familjare	20
Figura 19. Personi që vendos se si duhet të përdoren kursimet	20
Figura 20. Liria për të shpenzuar duke marrë parasysh disa skenarë.....	21
Figura 21. Pavarësia e të anketuarve nëse duhet të merrnin një vendim të rëndësishëm	22
Figura 22. Personi përgjegjës për punë të ndryshme shtëpiake	22
Figura 23. Kënaqësia me mënyrën se si ndahen shpenzimet ndërmjet partnerëve	23

ABSTRAKT

Ky studim synon të ofrojë të dhëna lidhur me vendimmarrjen e ekonomive familjare në zonat rurale në Kosovë. Më konkretisht, objektivi i këtij studimi është të analizojë se në çfarë mase burrat dhe gratë marrin vendime për aspekte të ndryshme të familjes në zonat rurale. Për të analizuar këtë çështje, është realizuar një anketë me 1100 të anketuar në zonat rurale në dhjetë komuna të Kosovës. Të gjeturat tregojnë se, në shumicën e familjeve, burrat, qoftë si i vetmi person apo si bashkë-vendimmarrës, janë më të angazhuar në vendimmarrjen e familjes sesa gratë. Megjithatë, në familjet ku gratë janë të punësuara dhe/ose të arsimuara mirë, të dhënat tregojnë se vendimmarrja është më e balancuar në aspektin gjinor. Duke pasur parasysh këto të gjetura, fuqizimi ekonomik i grave duket të jetë një faktor vendimtar që do të kontribuonte në vendimmarrjen e balancuar gjinore për familjet në zonat rurale.

HYRJE

Perceptimi si dhe të dhënat për vendimmarrjen e ekonomisë familjare kanë evoluar me kalimin e kohës. Teoria unitare e ekonomisë familjare supozon se familjet janë një grup individësh që kanë të njëjtat preferenca dhe bashkojnë plotësisht burimet e tyre (Becker, 1981).¹ Megjithatë, të dhënat empirike e kanë zhvendosur më tepër teorinë konvencionale të procesit të centralizuar të vendimmarrjes në një model "kolektiv" në të cilin anëtarët e familjes mund të kenë preferenca të ndryshme. Kjo nënkupton që ata jo detyrimisht bashkojnë plotësisht burimet dhe gjithashtu mund të bëjnë marrëveshje mbi kontributin e tyre si dhe konsumin.

Objektivi kryesor i këtij studimi është të analizojë rolin gjinor në vendimmarrje dhe të vlerësojë, deri diku, nivelin e barazisë ndërmjet burrit dhe gruas brenda ekonomive familjare në zonat rurale në dhjetë komuna të ndryshme në Kosovë. Përveç kësaj, ky studim synon gjithashtu të kontribuojë në debatin e vazhdueshëm mbi faktorët që ndikojnë në vendimmarrjen e grave brenda familjeve. Në mënyrë të veçantë, studimi fokusohet në ndikimin e gjenerimit të të ardhurave dhe edukimit në vendimmarrjen e grave në ekonominë familjare në zonat rurale në Kosovë. Punësimi diskutohet shpesh në literaturë si kontribues për barazinë gjinore dhe rëndësia e të ardhurave për gratë është theksuar në disa nisma dhe botime gjithashtu.

Rezultatet e studimit tregojnë se ka dallime në gjenerimin e të ardhurave dhe më pas në vendimmarrjen e ekonomive familjare sa i përket aspektit gjinor.² Gratë e punësuar në zonat rurale kanë autonomi dhe pjesëmarrje disproporcionalisht më të lartë në vendimmarrje në krahasim me gratë e papuna. Sfondi i nivelit arsimor gjithashtu ka rëndësi. Megjithatë, rezultatet e përgjithshme sugjerojnë se për vendime më "të rëndësishme" dhe me kosto më të lartë, është burri ai që ka më shumë fuqi në vendimmarrje.

Rezultatet e përgjithshme tregojnë se me rritjen e mundësive të ndryshme për punësim, gratë në zonat rurale duhet të kenë më shumë potencial për të bërë përmirësime në pozicionin e tyre dhe pjesëmarrjen në vendimmarrjen e familjes. Përmirësimi i qasjes së grave në burime financiare do t'i fuqizojë ato brenda shtëpive të tyre, dhe fuqizimi i tyre ekonomik do t'u mundësojë grave të sfidojnë më shumë stereotipe gjinore brenda ekonomive familjare në zonat rurale në Kosovë.

Ky studim është i organizuar në katër pjesë kryesore si në vijim. Në hyrje paraqitet një përshkrim i shkurtër i qëllimit të studimit; pjesa e dytë mbulon metodologjinë e studimit, ndërsa pjesa e tretë shtjellon të gjeturat kryesore nga anketa si dhe diskutimi në fokus grup. Shënimet përmblylëse duke përfshirë rekomandimet përkatëse nga studimi, janë përmbledhur në pjesën e fundit.

¹ Becker, G.S. (1981). Një traktat mbi familjen, Cambridge, MA: Harvard University Press.

² Për qëllimin e këtij studimi, termi 'ekonomi familjare/familje' është i kufizuar në marrëdhëniet në çift në familje private me ose pa fëmijë. Ndërkohë, 'vendimmarrja' kufizohet në marrjen e vendimeve nga çiftet për burimet e familjes.

METODOLOGJIA

Qëllimi kryesor i kësaj analize është të ofrojë një perspektivë gjinore për vendimmarrjen brenda ekonomive familjare në zonat rurale në 10 komunat e shënjestruara të projektit SIREG të zbatuar nga Caritas-i zviceran në Kosovë: Prishtinë, Prizren, Dragash, Graçanicë, Therandë, Viti, Kamenicë, Ranillug, Shtërpçë dhe Novobërdë. Për të kryer këtë studim, Riinvest ka përshtatur një metodologji të përdorur nga Kabeer (1999) dhe rekomandimet e Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën për matjen e fuqisë dhe vendimmarrjes brenda familjes³.⁴ Megjithatë, kjo metodologji është kontekstualizuar në mënyrë që të përbrendësohen faktorë specifik socio-kulturor në Kosovë. Studimi përdor të dhëna cilësore dhe sasore të cilat përbëhen nga një anketë e kryer në 10 komuna të Kosovës dhe përfshirë komunitetet jo shumicë dhe një diskutim në fokus grup me organizatat e shoqërisë civile.

Hulumtimi sasior (anketa)

Të dhënat primare janë mbledhur përmes një ankete të kryer me 1,100 intervista me ekonomi familjare në zonat rurale në 10 komunat e shënjestruara që përfaqësojnë popullacionin. Madhësia e mostrës konsiderohet e mjaftueshme për të ofruar rezultate statistikisht përfaqësuese për popullacionin (d.m.th. popullsinë rurale në komunat e shënjestruara) me marzh gabimi prej plus ose minus 3 pikë përqindjeje dhe një nivel besueshmërie 95 përqind. Për më tepër, mostra është shpërndarë në nivel komune duke përdorur një prag prej 9 pikë përqindjeje të marzhës së gabimit në mënyrë që të dhënat, në një masë të caktuar, të mund të analizohen në nivel komunal.

Tabela 1. Numri i të anketuarve në secilën komunë

Komuna	Numri i të anketuarve
Prishtinë	116
Prizren	116
Suharekë	115
Viti	114
Kamenicë	114
Dragash	114
Graçanicë	109
Shtërpçë	102
Novobërdë	102
Ranillug	99
Total	1,100

Duhet të theksohet se regjistrimi i fundit i kryer nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në vitin 2011 është përdorur si kornizë për mostrim. Pas ndërtimit të mostrës, hapi tjetër ka qenë hartimi i pyetësorit. Para fillimit të anketës, pyetësori fillimisht është testuar për të parë nëse disa pyetje duhej modifikuar për të marrë përgjigje të vërteta nga të anketuarit. Hapi i fundit i procesit të mostrimit ka qenë përzgjedhja e të anketuarve. Për të siguruar përfaqësim të duhur të

³ Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën. (2020). Rekomandime për matjen e fuqisë dhe vendimmarrjes brenda familjes.

⁴ Kabeer, N. (1999). 'Burimet, agjencia, arritjet: reflektime mbi matjen e fuqizimit të grave', Development and Change, Vol 30, pp. 435-464

popullacionit, është përdorur një përzgjedhje e thjeshtë e rastësishme e familjeve brenda lokacioneve të përzgjedhura. Pas hyrjes në familjen e përzgjedhur, anketuesve iu është kërkuar të identifikonin anëtarët e familjes të kualifikuar për intervistë sipas kritereve të mëposhtme: (i) personi të jetë 18 vjeç e lart, (ii) personi jeton me një partner dhe (iii) personi nuk është i sëmurë ose nuk vuan nga ndonjë gjendje që mund ta pengojë atë të marrë pjesë në intervistë. Për të siguruar përfaqësimin gjinor, brenda çdo familjeje, midis të gjithë çifteve që jetojnë në atë familje të caktuar, është zgjedhur ai/ajo që e kishte datën e lindjes më afër datës së intervistës.

Ekipi i Institutit Riinvest ka rekrutuar 20 anketues për mbledhjen e të dhënave. Të gjithë prej tyre kanë mbajtur trajnimin e duhur dy-ditor që i përgatitë për mbledhjen e të dhënave, specifikimin e pyetësorit dhe për t'u mundësuar anketuesve të njihen me objektivat, nevojat dhe dizajnin e anketës, me përmbajtjen e anketës, si dhe një fokus i veçantë iu është kushtuar qasjes së ndjeshme në aspektin gjinor që anketuesit duhej të përdornin. Grupe të vogla prej 2 deri në 5 anketues kanë punuar me një udhëheqës të ekipit. Udhëheqësi i ekipit ka ri-vizituar 15 përqind të të anketuarve për çdo anketues, gjoja për t'i falënderuar për bashkëpunimin e tyre. Gjatë këtyre vizitave, pyetjet e përzgjedhura që janë konsideruar më të rëndësishme për hulumtimin janë rikërkuar për verifikim. Përveç kësaj, çdo pyetësor është verifikuar nga hulumtuesit për të siguruar korrektësinë e plotësimit të pyetësorit dhe për të parë nëse pyetësi përmban ndonjë përgjigje jo logjike.

Pas grumbullimit, të dhënat janë koduar nga personel me përvojë duke përdorur tabelat EXCEL të përgatitura me fushat e të dhënave dhe tabelat që shfaqin kodet përkatëse. Më pas, të dhënat janë analizuar dhe janë para-interpretuar duke përdorur softuerin statistikor SPSS për të identifikuar përgjigjet jashtë kufijve të pritshëm, duke përfshirë mospërputhjet e mundshme midis variablave. Ndryshimet janë bërë sipas nevojës. Për më tepër, kontrollet periodike janë bërë nga udhëheqësi i projektit, kryesisht përmes krahasimit të mesatareve të ndryshoreve dhe shpërndarjeve nëpër skedarë, për t'u siguruar që të dhënat nuk janë ndryshuar, me ose pa qëllim. Analizat e hulumtimit në këtë raport bazohen kryesisht në statistika përshkruese duke përdorur teknika të kryqëzimit.

Hulumtimi cilësor

Pas përfundimit të punës në terren dhe analizës paraprake të të dhënave, ekipi ka zhvilluar një diskutim në fokus grup për të mbledhur mendime dhe ide ekspertësh mbi temat përkatëse për këtë studim. Metoda e fokus grupit mund t'i ndihmojë njerëzit të eksplorojnë dhe qartësojnë pikëpamjet e tyre në mënyra që do të ishin më pak të arritshme nga një anketë e opinionit publik. Për të analizuar më tej të dhënat e mbledhura përmes punës në terren dhe për të diskutuar temat e mundshme që dalin nga këto të dhëna, është organizuar një fokus grup me ekspertë në fushën e barazisë gjinore, të drejtave të grave dhe zhvillimit ekonomik. Shumica dërmuese e pjesëmarrësve ishin gra nga shoqëria civile, të cilat drejtojnë organizata që merren me fuqizimin ekonomik të grave, vendimmarrjen dhe të drejtat e grave. Për këtë qëllim është zhvilluar një pyetësor gjysmë i strukturuar nga ekipi i Riinvest dhe SIREN. Metodologjia e punës me fokus grup ka qenë kryesisht e orientuar drejt strukturimit të temës kryesore të diskutimit.

Diskutimi është organizuar në atë mënyrë që u lejoi pjesëmarrësve jo vetëm të komentonin të gjeturat e hulumtimit, por gjithashtu të jepnin mendimin e tyre se çfarë përfaqësojnë këto të gjetura nga një perspektivë më e gjerë e zhvillimit ekonomik dhe e barazisë gjinore. Gjatë diskutimit, pyetjet janë bërë në një mjedis grupor interaktiv ku pjesëmarrësit ishin të lirë të bisedonin me anëtarët e tjerë të grupit. Në fillim të diskutimit është marrë pëlqimi për incizimin e diskutimit të fokus grupit.


GJETJET

Në këtë pjesë, do të paraqiten të gjeturat kryesore nga anketa e cila është e ndarë në tri pjesë kryesore. Pjesa e parë paraqet të dhënat demografike të të anketuarve siç janë gjinia, mosha, niveli i arsimimit, statusi i punësimit dhe niveli i të ardhurave. Rezultatet në nivel familjar për aspekte të ndryshme të vendimmarrjes janë paraqitur në pjesën e dytë. Për disa tema specifike, rezultatet janë të ndara sipas gjinisë në mënyrë që të kemi një perspektivë më të thellë gjinore për tema të tilla. Rezultatet nga diskutimi në fokus grup janë paraqitur në pjesën e fundit të këtij seksioni.

Të dhënat demografike

Siç paraqitet në figurën 1, pothuajse 53 përqind e të anketuarve janë burra, dhe pjesa tjetër (më shumë se 47 përqind) janë gra. Pavarësisht se kjo strukturë e gjeneruar nga mostra është brenda marzhës së gabimit të paraqitur në pjesën e metodologjisë, ajo nuk është plotësisht në përputhje me të dhënat e popullsisë pasi, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në Kosovë ka më shumë gra sesa burra.⁵ Kjo mospërputhje e lehtë mund të jetë për shkak të disa normave shoqërore që mbizotërojnë në disa zona rurale.⁶ Gjithashtu, struktura gjinore e popullsisë në këto komuna jo domosdoshmërisht duhet të jetë e njëjtë me strukturën gjinore në nivel kombëtar.

Figura 1. Struktura gjinore e të anketuarve




Sa i përket moshës së të anketuarve, figura 2 ilustron përqindjen e secilës grupmoshë në mostër. Përderisa më shumë se 50 përqind e të anketuarve janë midis moshës 25 dhe 44 vjeç, vetëm 3.2 përqind e të anketuarve i përkasin grupmoshës 18-24 vjeç. Përqindja e ulët e të anketuarve më të rinj është e arsyeshme duke pasur parasysh kontekstin e Kosovës, pasi personat brenda kësaj

⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Regjistrimi i Popullsisë (2011) i qasshëm përmes portalit të të dhënave të ASK-së.

⁶ Për shembull, në zonat rurale, burrat, zakonisht kryefamiljari nëse është i pranishëm, insistojnë që të intervistohen sa herë që një grua nga e njëjta familje zgjidhet rastësisht për intervistë. Kur përballen me situata të ngjashme, anketuesit janë këshilluar që t'a kalojnë atë familje dhe të vazhdojnë me një familje tjetër, përveç nëse numri i familjeve në atë vend të caktuar (d.m.th. fshat) është aq i vogël, sa që zëvendësimi nuk mund të bëhet.


grupmoshe janë kryesisht të pamartuar, i cili ka qenë një nga kriteret kryesore të përzgjedhjes së të anketuarve, dhe për këtë arsye, ata janë të përjashtuar nga popullacioni që ne kemi synuar.

Figura 2. Struktura e moshës së të anketuarve



Niveli arsimor i të anketuarve është paraqitur në figurën 3. Siç është ilustruar, më shumë se 50 përqind e burrave kanë përfunduar arsimin e mesëm, ndërsa rreth 48 e grave kanë përfunduar të njëjtin nivel arsimor. Nga ana tjetër, më shumë se 33 përqind e grave kanë përfunduar arsimin e lartë, që është përqindje më e lartë se përqindja e burrave që kanë përfunduar këtë nivel arsimor.


Figura 3. Struktura e nivelit arsimor të të anketuarve sipas gjinisë



Rezultatet e statusit të punësimit janë të ngjashme me të dhënat e popullsisë (shih figurën 4). Vijat në këtë figurë tregojnë strukturën gjinore brenda statusit të caktuar të punësimit. Duke analizuar strukturën e të papunëve, kemi vërejtur një ndryshim domethënës midis burrave dhe grave; rreth 71 përqind e të anketuarve të papunë janë gra dhe pjesa tjetër janë burra. Vlen të


theksohet se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (11.7 përqind) punojnë për një biznes familjar, por nuk janë të punësuar apo të paguar.

Figura 4. Statusi i punësimit sipas strukturës gjinore



Sa i përket të ardhurave neto të të anketuarve, figura 5 ilustron rezultatet e anketës të ndara sipas gjinisë. Shumica e të anketuarve nga të dyja gjinitë fitojnë 250 deri në 800 EURO. Përderisa shumica e burrave (40.7 përqind) fitojnë nga 400 deri në 800 euro, kategoria më e zakonshme e të ardhurave neto për gratë është kategoria 250-400 euro.


Figura 5. Struktura e të ardhurave neto sipas gjinisë



Vendimmarrja në familje

Pyetja e parë në lidhje me vendimmarrjen kërkon nga të anketuarit të ndajnë informacione rreth menaxhimit të të ardhurave të familjes. Në më shumë se 47 përqind të familjeve, përfaqësuesi i çiftit tha se ata, si çift, i bashkojnë të gjitha paratë dhe i menaxhojnë së bashku (shih figurën 6). Për të njëjtën pyetje, në 35.1 përqind të rasteve përgjigja ishte se burri i menaxhon të gjitha paratë; kjo është një përqindje e lartë krahasuar me rastet kur përgjigja ishte se gruaja i menaxhon të gjitha paratë, që është vetëm 4.1 përqind.

Figura 6. Menaxhimi i të ardhurave familjare



Statusi i punësimit të gruas duket se luan një rol të rëndësishëm kur bëhet fjalë për menaxhimin e të ardhurave të familjes. Për të analizuar këtë aspekt, ne kemi gjeneruar rezultate duke krijuar dy nën-mostra, njëra që përfshin vetëm familjet në të cilat gruaja është e punësuar dhe tjetra me familjet ku gruaja është e papunë. Siç paraqitet në figurën 6, në familjet ku gruaja është e punësuar, gratë janë më të angazhuara në vendimmarrje në krahasim me ato familje ku gruaja është e papunë.


Meqenëse disa studime sugjerojnë se burrat priren të mbivlerësojnë kontributin e tyre në familje,⁷ ne kemi paraqitur rezultate të ndara sipas gjinisë së të anketuarit për të parë nëse ka

⁷ Lee, Y. S. and Waite, L. J., 2005. Husbands' and wives' measures. *Journal of marriage and family*, 67(2), pp.328-336.

ndonjë ndryshim midis përgjigjeve të tyre. Siç tregohet në figurën 6, ka dallime ndërmjet të anketuarve gra dhe burra (p.sh. meshkujt thanë se burri i menaxhon të ardhurat e familjes më shpesh sesa femrat); megjithatë, për të konkluduar nëse këto dallime shkaktohen vetëm për shkak të gjinisë së të anketuarit apo për të matur nëse këto dallime janë domethënëse apo jo, nevojiten më shumë karakteristika të familje të cilat do të na mundësonin të përdorim analiza më të avancuara.

Pasi që menaxhimi i të ardhurave është çështje thelbësore sa i përket vendimmarrjes në familje, veçanërisht nga aspekti ekonomik, ne kemi krijuar një nën-mostër tjetër duke përfshirë vetëm ato familje në të cilat gruaja ka përfunduar arsimin terciar dhe është e punësuar dhe krahasuar rezultatin e gjeneruar nga të gjithë të anketuarit. Siç mund ta shohim, në familjet në të cilat gruaja ka përfunduar arsimin e lartë dhe është e punësuar, vendimmarrja është më e balancuar nga pikëpamja gjinore (shih figurën 7).


Figura 7. Vendimmarrja, punësimi dhe arsimimi



Më pas, të anketuarve iu është kërkuar të vlerësojnë se kush i paguan shpenzimet mujore për atë familje. Siç paraqitet në figurën 8, në pothuajse 42 përqind të rasteve përgjigja ishte se burri paguan për të gjitha, në mesatare. Pothuajse në 50 përqind të rasteve përgjigja ishte se, sipas rregullit ose jo, ata ndajnë pagesën e shpenzimeve mujore. Nga ana tjetër, vetëm në 8.9 përqind të rasteve gruaja paguan për të gjitha.

Ashtu si në pyetjen e mëparshme, ne kemi krijuar dy nën-mostra për të parë nëse ka ndonjë dallim midis familjeve në të cilat gruaja është e punësuar dhe në ato në të cilat gruaja është e papunë. Siç pritej, gratë e punësuar janë më të angazhuara në menaxhimin e shpenzimeve mujore në familje pasi ato kanë qasje në të ardhura për dallim nga ato që janë të papuna. Për më tepër, ne kemi paraqitur rezultate të ndara sipas gjinisë së të anketuarit, për të parë nëse ka ndonjë ndryshim në lidhje me këtë çështje.

Figura 8. Menaxhimi i shpenzimeve mujore të ekonomisë familjare



Në një pyetje tjetër, të anketuarit janë pyetur se kush vendos për blerjet ditore në familje. Në këtë pyetje, përgjigjja më e shpeshtë (35.4 përqind) ishte se më së shumti gruaja vendos për blerje ditore. Një përgjigje tjetër e shpeshtë ishte se ndonjëherë gruaja/ndonjëherë burri me 27.5 përqind, mesatarisht. Rezultatet për opsionet e tjera janë paraqitur në figurën 9. Rezultatet e ndara sipas gjinisë së të anketuarve janë paraqitur edhe për këtë çështje.

Figura 9. Personi që vendos për blerjet ditore të familjes




Figura 10, jep informacione në lidhje me personin që vendos për blerje më të shtrenjta në familje. Siç mund të vërehet, në 48.4 përqind të familjeve është burri ai që vendos për këtë lloj blerjeje në shumicën e rasteve. Nga ana tjetër, vetëm në 1.7 përqind të rasteve, të anketuarit kanë thënë se gruaja vendos për blerje më të shtrenjta në shumicën e rasteve. Duke zbërthyer të dhënat bazuar në statusin e punësimit të gruas, vërejmë se gratë e punësuar janë më të përfshira kur merret vendimi për blerje më të shtrenjta.

Figura 10. Personi që vendos për blerjet më të shtrenjta të familjes





Figura 11. Personi që vendos për investime/blerje të gjërave kryesore të familjes



Për sa i përket investimeve dhe blerjes së gjërave kryesore për ekonomitë familjare, vërejmë se vendimi më së shpeshti merret nga të dy partnerët (shih figurën 11). Mirëpo, kjo nuk ndodh në ekonomitë familjare ku gruaja është e papunë, pasi burri është vendimmarrësi më i shpeshtë për investimet dhe blerjet e gjërave kryesore të familjes.

Në pyetjen lidhur me vendimin për shitjen e aseteve të familjes, rezultatet tregojnë se në më shumë se 50 përqind të rasteve, partnerët vendosin së bashku (shih figurën 12). Pavarësisht se kjo përqindje e lartë sugjeron një vendimmarrje më të barabartë gjatë analizimit të rasteve të tjera, vërejmë se në 42 përqind të familjeve këtë vendim e merr burri dhe vetëm në 1.4 përqind të rasteve gruaja.

Figura 12. Personi që vendos për shitjen e aseteve të familjes






Figura 13. Personi që vendos të marrë ose jo një kredi



Bazuar në të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës,⁸ aktiviteti i kredisë për banim është rritur sistematikisht ndër vite në Kosovë; prandaj, ne e shohim vendimin për të aplikuar për kredi dhe marrjen e saj si një çështje të rëndësishme për t'u eksploruar. Në këtë kontekst, përfaqësuesit e ekonomive familjare janë pyetur për vendimmarrjen kur bëhet fjalë për aplikimin për kredi. Të dhënat tregojnë se ky vendim zakonisht merret së bashku nga të dy partnerët, veçanërisht në familjet ku gruaja është e punësuar. Nga ana tjetër, në familjet ku gruaja është e papunë, zakonisht burri është vendimmarrës për sa i përket marrjes së kredisë (shih figurën 13). Rezultatet janë të ndara sipas gjinisë së të anketuarve edhe për këtë çështje.


Figura 14. Personi që vendos se sa para duhet të kursehen

⁸ Banka Qendrore e Kosovës (2011). Anketa e kreditimit bankar, në dispozicion në https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2021/08/BQK_AKB_nr.-8.pdf




Një çështje e rëndësishme në familje është vendimi se sa para duhet të kursehen. Në pyetjen se kush është vendimmarrësi për këtë aspekt, në 38 përqind të rasteve përfaqësuesi i familjes është shprehur se të dy partnerët vendosin bashkë, 30 përqind janë shprehur se vendimmarrësi është burri dhe rreth 11 përqind kanë thënë se gruaja vendos sa para duhet kursyer (shih figurën 14). Ashtu si në disa nga pyetjet e mëparshme, ne kemi krijuar dy nën-mostra me familje në të cilat gruaja është e punësuar ose e papunë. Duke parë rezultatet nga këto nën-mostra, vërejmë një përfshirje më të madhe të grave që janë të punësuar kur vendosin sa para të kursejnë.

Figura 15. Kush ka të ardhura më të larta?



Për sa i përket të ardhurave të partnerëve, përfaqësuesit e familjes janë pyetur të vlerësojnë se cili prej partnerëve ka të ardhura më të larta. Në pothuajse 60 përqind të familjeve, burri ka të ardhura më të larta se gruaja, në 5,2 përqind të rasteve gruaja ka të ardhura më të larta dhe në 23,1 përqind të familjeve, partnerët kanë të ardhura afërsisht të njëjta.


Figura 16. Personi që duhet të marrë vendimet e rëndësishme në familje



Të anketuarit ndanë mendimin e tyre se kush duhet të marrë vendimet e rëndësishme në familje. Rezultatet tregojnë se shumica dërrmuese e tyre (79.6%) mendojnë se të dy partnerët duhet të marrin vendime të rëndësishme. Kur ndahen në nivel gjinor, vërejmë se 23 përqind e burrave mendojnë se burri duhet të marrë një vendim të rëndësishëm në familje, ndërsa më shumë se 83 përqind e grave mendojnë se vendimet e rëndësishme duhet të merren nga të dy partnerët së bashku (shih figurën 16).

Në pyetjen se kush është pronari ligjor i pronës në të cilën banon familja, pothuajse në 75 përqind të rasteve të anketuarit kanë thënë burri është pronari ligjor, ndërsa vetëm në rreth 2 përqind të rasteve kanë thënë se pronari ligjor është gruaja (shih figurën 17). Bashkëpronësia dhe pronarët e tjerë si dy përgjigje të mundshme përfaqësojnë më shumë se 23 përqind të rasteve; kjo mund të jetë për shkak se në zonat rurale familjet përbëhen nga më shumë se një çift, prandaj mund të ketë më shumë pronarë të ligjshëm.

Figura 17. Pronari ligjor i pronës në të cilën banon familja



Për të analizuar procesin e vendimmarrjes, të anketuarit janë pyetur se kush është përgjegjës për vendime të tilla si planifikimi për shkollim, planifikimi familjar, vendbanimi, udhëtimet dhe festimet familjare. Rezultatet sugjerojnë se në shumicën e familjeve në zonat rurale, të dy partnerët janë përgjegjës për vendimet e lartpërmendura (shih figurën 18). Ndërsa në 22 përqind të familjeve burri është përgjegjës për vendbanimin, në 11 përqind të rasteve gruaja është përgjegjëse për një festë familjare.

Figura 18. Personi përgjegjës për: planifikimin për shkollim, planifikimin familjar, vendbanimin, festat familjare





Figura 19. Personi që vendos se si duhet të përdoren kursimet



Ndërsa në një rën nga pyetjet e mëparshme, të anketuarit janë pyetur se kush vendos se sa para duhet të kursehen, në një pyetje tjetër ata janë pyetur nëse aktualisht kanë ndonjë kursim të përbashkët; në 42 përqind të rasteve përgjigja ka qenë pozitive. Pyetja vijuese ishte se kush është përgjegjës për mënyrën se si duhet të përdoren kursimet. Rezultatet janë ilustruar në figurën 19; në më shumë se 76 përqind të familjeve, përfaqësuesi tha se ai/ajo dhe partneri i tij/saj vendosin në mënyrë të barabartë. Përveç kësaj, ne kemi paraqitur rezultatet të ndara sipas gjinisë së të anketuarve.

Në një rën prej pyetjeve, të anketuarit janë pyetur nëse ndjehen të lirë të shpenzojnë para për veten, fëmijët apo në një situatë kur ka ndodhur një e papritur, pa kërkuar leje nga partneri. Rezultatet janë paraqitur në figurën 20. Siç mund ta shohim, shumica e burrave dhe grave do të ndiheshin të lirë ose gjithmonë ose ndonjëherë të shpenzonin para për situatat e përmendura pa kërkuar leje. Megjithatë, afërsisht një e treta e grave dhe burrave të anketuar priren të mos ndihen rehat për të marrë vendime të tilla pa marrë leje nga bashkëshortët e tyre.

Figura 20. Liria për të shpenzuar duke marrë parasysh disa skenarë






Figura 21. Pavarësia e të anketuarve nëse duhet të merrnin një vendim të rëndësishëm



Sa i përket pavarësisë për të marrë një vendim, të anketuarit janë pyetur se çfarë do të bënin nëse do të duhej të merrnin një vendim të rëndësishëm. Duke qenë se kjo ishte një pyetje personale për të anketuarit, ne kemi paraqitur rezultatet në figurën 21 të ndara sipas gjinisë. Të dyja gjinitë në më shumë se 50 përqind të rasteve thanë se do të merrnin parasysh interesin e partnerit ose të familjes së tyre përpara se të merrnin një vendim të rëndësishëm. Një trend tjetër që vërejmë është se gratë më shumë se burrat kanë raportuar se kanë nevojë për miratimin e partnerit të tyre kur duhet të marrin një vendim të rëndësishëm.

Figura 22. Personi përgjegjës për punë të ndryshme shtëpiake



Sa i përket punëve të shtëpisë, përfaqësuesi i familjes është pyetur se kush është përgjegjës për gatimin, pastrimin, mirëmbajtjen e kopshtit. Figura 22 jep informacion në lidhje me rezultatet e krijuara nga kjo pyetje. Siç tregohet, në shumicën dërrmuese të familjeve, gruaja është përgjegjëse për gatimin dhe pastrimin. Nga ana tjetër, për mirëmbajtjen e kopshtit, më së shpeshti zgjidheshin të dy partnerët si njësoj përgjegjës.

Së fundi, të anketuarit janë pyetur të vlerësonin në një shkallë nga 1 (plotësisht të pakënaqur) në 10 (plotësisht të kënaqur) se sa të kënaqur janë me mënyrën se si ndahen shpenzimet e familjes ndërmjet partnerëve. Në figurën 23, kemi paraqitur mesataren e përgjigjeve të burrave dhe grave. Siç tregohet, burrat janë mesatarisht pak më të kënaqur se gratë.

Figura 23. Kënaqësia me mënyrën se si ndahen shpenzimet ndërmjet partnerëve




Tabela 2 përmban rezultatin e ndarë sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike të të anketuarve për pyetjet që i konsideruam si më të rëndësishmet për këtë temë. Arsyeja që ne paraqitëm rezultatin e ndarë sipas gjinisë së të anketuarit është për të parë nëse ka ndonjë ndryshim midis përgjigjeve të burrave dhe grave; siç e përmendëm më herët disa studime të këtij lloji tregojnë se burra priren të mbivlerësojnë kontributin e tyre në familje gjë e cila mund të ndikoj përgjigjet e tyre për vendimmarrje gjithashtu. Siç shihet ne tabelë, ka dallime ndërmjet të anketuarve burra dhe gra në disa nga pyetjet. Megjithatë, këto dallime mund të shkaktohen nga faktorë të tjerë që përfshijnë karakteristikat e asaj familjeje që intervistohet. Për të arritur në një përfundim më të saktë, nevojiten të dhëna më të detajuara të cilat do të na mundësonin kryerjen e analizave më të avancuara ekonometrike.

Sa i përket përkatësisë etnike, ka dallime ndërmjet familjeve shqiptare dhe serbe lidhur me menaxhimin e të ardhurave dhe vendimet për blerje të ndryshme në familje. Një trend që vërejmë është se në familjet serbe, vendimet që ne i konsiderojmë si më të rëndësishëm, të dy partnerët vendosin së bashku më shpesh sesa në familjet shqiptare. Një gjetje tjetër është se burri në familjet serbe është i vetmi vendimmarrës më rrallë se në familjet shqiptare.

Tabela 2. Përmbledhje e rezultateve të ndara sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike të të anketuarve

Pyetja	Përgjigjeja e mundshme	Gjinia		Përkatësia etnike	
		Burri	Gruaja	Shqipatre	Serbe
Kush i menaxhon të ardhurat e familjes?	Gruaja menaxhon të gjitha paratë	3.7%	4.5%	3.4%	5.2%
	Burri menaxhon të gjitha paratë	37.3%	30.1%	40.1%	24.8%
	Ne grumbullojmë të gjitha paratë dhe i menaxhojmë së bashku	44.6%	48.8%	44.9%	48.9%
	Ne grumbullojmë disa nga paratë dhe pjesën tjetër e mbajmë veçmas	9.0%	11.6%	7.3%	15.0%
	Ne secili i mbajmë paratë tona veçmas	3.2%	3.0%	1.3%	5.4%
	Tjetër	2.3%	2.0%	3.0%	0.7%
Kush i menaxhon shpenzimet mujore të familjes?	Gruaja paguan për gjithçka	9.3%	8.1%	7.9%	10.3%
	Burri paguan për gjithçka	43.6%	37.3%	42.9%	36.9%
	Ne të dy paguajmë në pjesë afërsisht të barabarta	16.5%	22.8%	17.3%	22.6%
	Ne të dy paguajmë në raport me të ardhurat tona	9.1%	11.4%	10.6%	9.3%
	Të dy paguajmë disa prej tyre, por nuk ka një rregull të caktuar	19.0%	18.9%	18.2%	20.9%
	Tjetër	2.5%	1.6%	3.3%	0.0%
Kush zakonisht merr vendime për blerje të herëpashershme më të shtrenjta për familjen?	Kryesisht gruaja	1.9%	1.4%	2.1%	1.0%
	Kryesisht burri	49.0%	45.0%	47.6%	47.4%
	Ndonjëherë unë/ndonjëherë bashkëshorti/partneri im	15.0%	17.7%	15.1%	17.0%
	Ne vendosim së bashku	31.4%	34.6%	31.9%	34.6%
	Dikush tjetër	2.6%	1.4%	3.3%	0.0%
Kush zakonisht merr vendime për investimin/blerjen e gjërave kryesore për familjen?	Kryesisht gruaja	1.6%	1.8%	1.5%	2.0%
	Kryesisht burri	43.7%	35.4%	46.9%	29.5%
	Ndonjëherë unë/ndonjëherë bashkëshorti/partneri im	9.5%	12.6%	11.4%	9.6%
	Ne vendosim së bashku	41.4%	48.2%	35.8%	58.7%
	Dikush tjetër	3.7%	2.0%	4.3%	0.2%
Kur ju dhe bashkëshorti/partneri juaj merrni vendime për shitjen e aseteve të familjes, kush e ka fjalën e fundit?	Kryesisht gruaja	1.6%	1.2%	1.8%	0.7%
	Kryesisht burri	42.9%	37.0%	46.5%	31.2%
	Ne vendosim së bashku	51.4%	58.9%	47.4%	65.8%
	Tjetër	2.3%	2.0%	3.0%	0.7%
	N/A	1.8%	1.0%	1.2%	1.5%
Kush i merr vendimet për marrjen e një kredie?	Kryesisht gruaja	1.2%	2.4%	1.5%	2.5%
	Kryesisht burri	39.4%	33.5%	36.8%	37.2%
	Ne vendosim së bashku	49.0%	58.3%	50.8%	56.9%
	N/A	10.3%	5.9%	10.9%	3.4%
Kush merr vendime se sa para nga të ardhurat e familjes të kursehen?	Kryesisht gruaja	9.8%	9.9%	9.7%	10.9%
	Kryesisht burri	27.9%	28.2%	25.0%	31.4%
	Ndonjëherë unë/ndonjëherë bashkëshorti/partneri im	21.3%	19.5%	25.0%	13.3%
	Ne vendosim së bashku	35.3%	37.1%	34.7%	39.3%
	N/A	5.7%	5.3%	5.6%	5.2%

Gjetjet nga diskutimi në fokus grup

Përveç të dhënave sasiore të mbledhura nga anketa, ekipi ka organizuar edhe një diskutim në fokus grup. Diskutimi i fokus grupit u zhvillua në fund të tetorit në Prishtinë dhe përbëhej nga tetë pjesëmarrës të cilët u përzgjedhën në bazë të ekspertizës, njohurive dhe përvojës së tyre në fushat përkatëse. Shumica e tyre punojnë në fusha që lidhen me analizën dhe zhvillimin gjinor. Diskutimi u hap me prezantimin e disa prej gjetjeve më të rëndësishme të anketës. Në përgjithësi, gjetjet në një masë të madhe u vërtetuan nga të gjithë pjesëmarrësit. Sipas pjesëmarrësve, siç sugjerojnë të dhënat, pabarazia në të ardhura mund të jetë arsyeja kryesore pse burrat kanë më shumë fuqi vendimmarrëse në familjet rurale në Kosovë (në shumicën e familjeve rurale, burrat janë të vetmit vendimmarrës ose së paku bashkë-vendimmarrës).

Një çështje tjetër e rëndësishme që u diskutua midis pjesëmarrësve ishte fakti se në shumicën e familjeve rurale të ardhurat mujore të familjes janë më të ulëta në krahasim me zonat urbane, gjë që mund të ndikojë në procesin e përgjithshëm të vendimmarrjes pasi shumica e shpenzimeve të familjes janë të paracaktuara (dmth. shërbimet komunale dhe të tjera mallrat e nevojshme). Ndërsa disa nga pjesëmarrësit besojnë se pavarësisht nga niveli i të ardhurave, duhet të ketë një lloj diskutimi dhe konsensusi ndërmjet anëtarëve kur bëhet fjalë për shpërndarjen e buxhetit të përgjithshëm të familjes. Nga ana tjetër, grupi tjetër mendon se ka pak hapësirë për diskutim sa i përket procesit të vendimmarrjes pasi buxheti është i kufizuar dhe pjesa më e madhe e tij shpenzohet për mallra dhe shërbime bazë.

Vendimi për blerjet familjare është një tjetër aspekt që u diskutua në mesin e pjesëmarrësve në fokus grup. Në parim, ata ranë dakord që, siç sugjerojnë gjetjet, burrat kanë më shumë fuqi kur bëhet fjalë për blerjet më të shtrenjta dhe gratë zakonisht vendosin për blerjet ditore. Bazuar në përvojën e tyre, si dhe në provat anekdotike, ata besojnë se situata është më e mirë në zonat urbane ku çiftet zakonisht marrin vendimet financiare së bashku duke e bërë procesin e vendimmarrjes më të balancuar nga pikëpamja gjinore në krahasim me zonat rurale.

Në fund, pjesëmarrësit u pajtuan se fuqizimi i gruas në ekonomi është faktori më i rëndësishëm që do të rriste angazhimin e grave në vendimmarrjen familjare. Në mënyrë të veçantë, fuqizimi përmes përmirësimit të qasjes në tregun e punës si dhe arsimimi për gratë në zonat rurale është një implikim kyç i politikave që rrjedh nga të dhënat e anketës që kërkojnë vëmendje të menjëhershme nga politikëbërësit. Së fundi, u argumentua gjithashtu se aktivitetet sistematike të avokimit të kanalizuar përmes organizatave të shoqërisë civile do të përmirësonin gjendjen e përgjithshme të grave në komunitetet rurale në Kosovë.

SHËNIMET PËRMBYLLËSE DHE REKOMANDIME

Ky raport analizon vendimmarrjen e familjeve në zonat rurale në Kosovë. Me sa kuptojmë, ka shumë pak studime të këtij lloji në Kosovë, të cilat ende nuk janë publikuar.⁹ Prandaj, përmes këtij studimi konsiderojmë që ofrojmë dëshmi të reja të cilat mund të jenë të dobishme për politikëbërësit dhe akterët e tjerë përkatës. Gjetjet tona, në përputhje me literaturën,¹⁰ sugjerojnë që statusi i punësimit të grave luan një rol të rëndësishëm në vendimmarrjen e familjes. Më saktësisht, vendimmarrja është më e balancuar në aspektin gjinor në familjet ku gruaja është e punësuar. Gjetjet kryesore të këtij studimi janë përmbledhur si më poshtë:

- Çiftet menaxhojnë së bashku të ardhurat e familjes në 47 përqind të totalit të familjeve të intervistuar. Ndërsa në 35 përqind të rasteve burri menaxhon të ardhurat e familjes, gruaja menaxhon vetëm 4 përqind të mostrës totale.
- Sa i përket vendimit për blerjet në familje, vërejmë se për blerjet ditore zakonisht gruaja është vendimmarrëse, por kur bëhet fjalë për blerjet më të shtrenjta, më së shpeshti burri është vendimmarrës. Për sa i përket investimeve dhe blerjes së gjërave kryesore të familjes, vendimi zakonisht merret së bashku nga të dy partnerët.
- Kur bëhet fjalë për shitjen e aseteve të familjes, në më shumë se 50 përqind të rasteve partnerët vendosin së bashku. Megjithatë, kur shikohen rezultatet për opsionet e tjera, burri vendos në 42,2 përqind të rasteve dhe gruaja vetëm në 1,4 përqind të familjeve.
- Marrja e kredisë është një vendim për të cilin në 58 përqind të familjeve vendosin partnerët bashkë, ndërsa në 40 përqind vendos burri dhe vetëm në 2 përqind gruaja e merr këtë vendim.
- Për sa i përket kursimeve, 38 përqind e të anketuarve kanë thënë se partnerët vendosin së bashku se sa para të kursejnë, pasuar nga 29 përqind që thonë se më së shumti burri e merr këtë vendim dhe 10,5 përqind që thonë se më së shumti vendos gruaja.
- Nga ato familje në të cilat partnerët kanë kursime të përbashkëta, në 76 përqind të rasteve, i anketuari tha se partnerët kanë thuar se të barabartë fjalën se si duhet përdorur kursimi.
- Për sa i përket vendimeve të rëndësishme, në shumicën e familjeve, përfaqësuesi i familjes tha se të dy partnerët vendosin së bashku për çështje të tilla si planifikimi për shkollim, planifikimi familjar, udhëtimi, vendbanimi, festa familjare. Duke parë aspektin gjinor, vërejmë se ndërsa burri është më shpesh përgjegjës për të vendosur për vendbanimin, gruaja është përgjegjëse për festimet familjare (p.sh. dasma, ditëlindje, etj.).
- Shumica dërrmuese e përfaqësuesve thanë se gruaja është përgjegjëse për gatimin dhe pastrimin në atë familje. Për sa i përket mirëmbajtjes së kopshtit, përgjigja më e zakonshme ishte se të dy partnerët janë përgjegjës për këto aspekte.

⁹ Ky informacion është siguruar nga një nga pjesëmarrësit e fokus grupit, puna e të cilit është e fokusuar në studimet gjinore.

¹⁰ Acharya, D.R., Bell, J.S., Simkhada, P. et al. Autonomia e grave në vendimmarrjen familjare: një studim demografik në Nepal (2010).

- Mesatarisht, burrat janë pak më të kënaqur me mënyrën se si ndahen shpenzimet e familjes mes partnerëve.

Rekomandimet e mëposhtme rrjedhin nga të dhënat e mbledhura në terren që tregojnë se nga perspektiva gjinore vendimmarrja në ekonominë shtëpiake rurale në 10 komuna të Kosovës ndikohet nga faktorë të ndryshëm më së shumti si rezultat i normave, pritjeve dhe roleve të rrënjësura gjinore që ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat. Si e tillë, vendimmarrja e grave në nivel familjar, në përgjithësi, është më e dobët në krahasim me burrat, kryesisht për shkak të të drejtave dhe mundësive të pabarabarta ekonomike, shkallës më të ulët të punësimit të grave, pronës më të ulët të tokës dhe pronës së grave.

Duke marrë parasysh rezultatet e mësipërme, ne rekomandojmë që disa aspekte të merren parasysh gjatë punës me gratë në zonat rurale dhe drejt fuqizimit të tyre më shumë nëpërmjet fuqisë vendimmarrëse:

- Mbështetja e Ministrisë së Bujqësisë dhe institucioneve të tjera përkatëse në adresimin e aktivitetit ekonomik informal të grave, veçanërisht të atyre në zonat rurale që merren me bujqësi.
- Mbështetja dhe inkurajimi i diversifikimit të të ardhurave dhe mundësive të punësimit për gratë dhe burrat në zonat rurale.
- Fuqizimi i grave në zonat rurale përmes iniciativave të qëndrueshme në fushën e arsimit, të cilat do t'u mundësojnë atyre të jenë të sigurta ekonomikisht dhe në shoqëri. Mbështetja e hartimit dhe zbatimit të programeve që synojnë pjesëmarrjen e vajzave dhe grave në arsimin formal dhe joformal me fokus në studimet e bujqësisë.
- Të merren masat e nevojshme gjatë zbatimit të projektit për të siguruar përmirësimin e qasjes së grave në pronë dhe të drejtave të tyre pronësore.
- Sigurimi i informacionit të qasshëm mbi pronësinë e grave dhe të drejtat e tokës në zonat rurale.
- Të sigurohet mbështetje dhe udhëzim për partnerët e projektit dhe institucionet përkatëse për të reduktuar barrën e grave për regjistrimin dhe gëzimin de facto të të drejtave të tyre mbi tokën, duke përfshirë promovimin e mbledhjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë për qasjen në pronë, në përputhje me nenin 14 të Komisionit për Eliminimi i Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).
- Projekti duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë vendeve ku zhvillohen takime dhe trajnime të projektit të ardhshëm duke marrë parasysh lëvizshmërinë dhe qasjen e grave në zonat rurale. Shmangia e vendeve ku qasja e grave mund të jetë më e vështirë.
- Pushteti vendor të sigurojë që transporti publik të arrijë në të gjitha zonat rurale në mënyrë që gratë të kenë transportin e nevojshëm për të pasur qasje në ngjarjet ose shërbimet publike.
- Komuniteti i OSHC-ve dhe projekti, në veçanti, të avokojnë për përfshirjen e akterëve që përfaqësojnë interesat e grave fermere dhe grave që jetojnë në zonat rurale në hartimin e politikave, planeve kombëtare të veprimit dhe strategjive kombëtare.